

URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën
vëzhgim të përhershëm

25 tetor 2013, Prizren

Komunikatë #5

KOMUNIKATË PËR MEDIA**PZHKP të shërbej si pikënisje për ndalimin e degradimit urbanistik në Prizren**

Monitoruesit e “EC Ma Ndryshe” në kuadër të projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm” kanë përcjellë me vëmendje procesin e miratimit të Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit 2013-2025, që paraqet një dokument statutor që udhëheq zhvillimin e komunës përgjatë dekadës në vijim. PZHKP është miratuar nga Kuvendi i Komunës më 17 shtator 2013.

Në këtë dokument bëhet e ditur se Komuna e Prizrenit është e përkushtuar që të zbatojë PZHKP-në duke iu referuar Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ dhe duke u bazuar në Ligjet përkatëse të Kosovës. Planit Zhvillimor i Komunës së Prizrenit (PZHKP), është plan shumë sektorial që ofron një kornizë të gjerë dhe paraqet udhëzime për zhvillimin e Komunës së Prizrenit, duke marrë parasysh rritjen e tanishme dhe atë të planifikuar të popullatës.

Mirëpo PZHKP-ja konfirmon se “sot, Prizreni ballafaqohet me shumë sfida në menaxhimin e resurseve të saja dhe të territorit” me theks të veçantë në trashëgiminë kulturore dhe historike. PZHKP thekson se numri i madh i monumenteve historike e bëjnë Prizrenit një lokacion shumë atraktiv për vizitorët si nga Kosova ashtu edhe nga jashtë.

“Mirëpo, trashëgimia kulturore në Prizren është në degradim e sipër. Mungesa e përpjekjeve për konservim, ndërtimet e reja përkundër planeve konservuese dhe stoku i pashfrytëzuar i ndërtimit rezultojnë në probleme të mëdha fizike”, thuhet në këtë dokument, ku sqarohet se Planit për Konservimin e Zonës Historike të Prizrenit është një aset fundamental për ruajtjen e qëndrueshmërisë së trashëgimisë kulturore, që megjithatë nuk ka gjetur zbatim as disa vite pas miratimit. “Zhvillimet që kundërshtojnë planin e konservimit mund të vërehen qartë në qendrën historike të qytetit që rezulton me degradimin e karakterit historik”, thekson PZHKP.

Edhe në pjesën ku flitet për zhvillimin e turizmit PZHKP konstaton se trashëgimia kulturore, sidomos në Prizren, është duke u shkatërruar si rezultat i mungesës së përpjekjeve konservuese, si dhe ndërtimeve të reja në kundërshtim me planet për konservim.

PZHKP përshkruan se sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Nr.03/L-039/2008) dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Nr.04/L-066/2012) Qendra Historike e qytetit të Prizrenit është shpallur zonë e mbrojtur. Por kjo zonë sipas vëzhgimeve dhe raportimeve të EC Ma Ndryshe nuk po mbrohet edhe pse ekziston Planit për ruajtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit, që ka prodhuar propozime për planifikim në aspektin e çështjeve fizike, shfrytëzimit të tokës, transportit dhe çështjeve që kanë të bëjnë me konservimin, ndërkohë që në fuqi janë edhe disa ligje të aprovuara në Kuvendin e Kosovës që parashohin masa mbrojtëse për Qendrën e vjetër dhe pronat e trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

Në bazë të këtyre përshkrimeve EC Ma Ndryshe konsideron se autoritetet komunale duhet të tregojnë përkushtim shumë më të madh në ruajtjen e vlerave të Qendrës Historike të Prizrenit dhe të trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe ti zbatojnë në përpikëri udhëzimet e ofruara në kuadër të PZHKP-së.

EC Ma Ndryshe përkujton se edhe Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit, 2003-2013, kishte nënvizuar rëndësinë e madhe të trashëgimisë kulturore dhe historike të Prizrenit për zhvillimin e turizmit, ndërkohë që në realitet autoritetet komunale nuk kanë ndërmarrë masa adekuate për ruajtjen e saj, por me veprimet e tyre i kanë kontribuar degradimit të mëtejshëm. I njëjti fat e ka përcjell edhe Planin e Konservimit, dokument i miratuar në vitin 2008 nga komuna, por që vazhdon të shkelet dhe injorohet sistematikisht.

Ne i bëjmë thirrje komunës së Prizrenit që praktikën e jetësuar me PZHUP-në të mos e përsëris edhe me PZHKP-në, por që përfundimisht të shfrytëzoj këtë dokument si pikënisje për të iniciuar veprime konkrete për ndalimin e degradimit urbanistik, që tashmë ka marrë përmasa shqetësuese brenda qytetit.

“EC Ma Ndryshe” në korrik ka nisur zbatimin e projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Nevoja për mbikëqyrjen e zhvillimeve në sektorin e urbanizimit ka rrjedhë si pasojë e zhvillimeve të shumta negative gjatë periudhës së pasluftës dhe tranzicionit që janë manifestuar me degradimin urban dhe planifikimin e pa-balancuar hapësinor. Projekti do të vazhdoj me monitorimin dhe publikimin e të gjeturave në sektorin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, sikurse edhe me adresimin e përgjegjësisë institucionale.

Me nderime,

Valon Xhabali, Koordinator i Projektit

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren & Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo